



# Behind the Masks

# Prapa Maskave

**giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

On behalf of  
**BMZ**

 Federal Ministry for Economic Cooperation and Development

**KALO ASSOCIATES**  
ATTORNEYS AT LAW

  
United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women



Prapa Maskave



Behind the Masks



## Introduction

The idea for this book came about whilst visiting the museum of contemporary art in Zagreb. Sanja Iveković had created a display consisting of pillars on top of which the plaster casts of women's faces, along with their stories of violation and violence, inflicted on them mainly by their partners, were placed.

The idea of presenting anonymous women along with their true life stories was transposed: 34 Albanian women, from towns and villages, old and young, rich and poor, employed and unemployed, were interviewed and photographed whilst wearing white Venetian masks (made in Shkodra), to avoid them being recognized.

The common topic of the interviews is COMPROMISE. This topic was chosen for two main reasons: firstly, compromise is the essence of the European Union, of which Albania would like to become a member, and secondly, women rarely have a voice in daily life and the compromises they make in their lives are often forgotten.

Originally, the interviews and photographs were shown at an exhibition that was displayed at the Euro Info Center on Women's Day, on 8<sup>th</sup> March. Its success was such that a decision was made to publish a book, a venture that would not have been possible without the support of KALO & ASSOCIATES and without the great efforts of Erlanda Agaj, Adela Llatja, Ardjana Shehi and Maja Zarić.

Those who have contributed to this book all work in different areas, including both the private and public sectors. They also all come from very different backgrounds including Albania, Germany and the UN (thus representing all of its 193 member states). However, the common goal is evident: to achieve gender equality. It is hoped that this book will contribute to our important and shared goal!

Judith Knieper (GIZ)



Ardjana Shehi (KALO & ASSOCIATES)



Semia Solange Guermas de Tapia (UN Women)



Interviews: Erlanda Agaj (GIZ), Adela Llatja (GIZ) and Ardjana Shehi (from Kalo and Partners)

Editing of the English texts: Maja Zarić (function)

Photos: Erlanda Agaj, Adela Llatja, Judith Knieper, Florian Raunig and Maja Zarić

## Hyrje

Idea për shkrimin e këtij libri na erdhi teksa po vizitonim muzeun e artit kontenporan në Zagreb. Sanja Iveković kishte krijuar një stendë me kolona, në të cilat ishin vendosur derdhje në allçi e fytyrave të disa grave, së bashku me historitë e dhunës së ushtruar mbi to, kryesisht nga partnerët.

Nga kjo ekspozitë u mor idea e prezantimit në anonimitet e histori të vërteta të jetës së disa grave: 34 gra shqiptare, nga qyteti dhe nga fshati, të moshura dhe të reja, të pasura dhe të varfra, të papuna dhe të punësuara u intervistuan dhe u fotografuan me maska veneciane (të bëra në Shkodër), për të shmangur identifikimin.

Tema e përbashkët e intervistave ishte KOMPROMISI. Tema u zgjedh për dy arsye kryesore: së pari, kompromisi është thelbi i Bashkimit Evropian, ku Shqipëria dëshiron të anëtarësohet dhe, së dyti, gratë rrallë kanë mundësi të shprehen në jetën e përditshme dhe kompromiset që ato bëjnë në jetën e tyre shpesh harrohen.

Fillimisht intervistat dhe fotografitë u ekspozuan në ekspozitën e hapur në Qendren e Informacionit të BE-së, në Ditën e Grave, më 8 mars 2012. Ekspozita ishte kaq e suksesshme, sa që u vendos të botohej një libër, një sipërmarrje që nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e KALO & ASSOCIATES dhe pa përpjekjet e mëdha të Erlanda Agaj, Adela Llatja, Ardjana Shehi dhe Maja Zarić.

Personat që kanë kontribuar për këtë libër punojnë të gjithë në fusha të ndryshme, duke përfshirë si sektorin privat dhe atë publik. Ato kanë prejardhje të ndryshme, duke përfshirë Shqipërinë, Gjermaninë dhe Kombet e Bashkuara (të cilat përfaqësojnë të 193 shtetet anëtare të saj). Ato të gjitha kanë një objektiv të qartë: arritjen e barazisë gjinore. Shpresojmë që ky libër t'i shërbejë qëllimit tonë të rëndësishëm dhe të përbashkët!

Judith Knieper (GIZ)



Ardjana Shehi (KALO & ASSOCIATES)



Semia Solange Guermas de Tapia (UN Women)



Intervistat: Erlanda Agaj (GIZ), Adela Llatja (GIZ) dhe Ardjana Shehi (nga Kalo and Partners)

Redaktimi i tekstit në anglisht: Maja Zarić

Fotografitë: Erlanda Agaj, Adela Llatja, Judith Knieper, Florian Raunig dhe Maja Zarić



## **Judith, 42 vjeç, 2 fëmijë, e martuar, Juriste**

Thelbi i Bashkimit Evropian është kompromisi: në përgjithësi, zgjidhjet nuk diktohen nga vota e shumicës, por ideja është të arrihet një vendim njëzëri, të tejkalohen dallimet dhe të gjendet zgjidhja më e mirë për të gjithë. Ndoshta, kjo është arsyeja kryesore pse shtetet anëtare kanë arritur të evitojnë konfliktet për më shumë se 65 vjet, si dhe që vazhdojnë thellimin e integritimit të shteteve anëtare, që, së shpejti do të bëhen 28 e që kanë një sfond kulturor, etnik, gjuhësor dhe ekonomik mjaft të ndryshëm.

Në qoftë se, nga ana tjetër, ai që bën kompromis shihet si dështak, i dobët, pa shtyllë kurrizore, atëherë integrimi brenda shoqërisë dhe brenda rajonit është i largët.

Kompromisi është pikë e fortë. Nga përvoja ime këtu, gratë janë më të gatshme të bëjnë kompromise sesa burrat: kjo është një nga pikat e tyre të forta dhe duhet mbështetur më tej.

## **Judith, aged 42, 2 children, married, lawyer**

The essence of the European Union is compromising: in general, solutions are not dictated by majority vote but the idea is to reach unanimity, to overcome differences and find the possible best solution for everyone. Probably this is the main reason why the member states were able to avoid major conflicts for more than 65 years already and proceeded in the deepening of integration of soon 28 countries with very different cultural, ethnic, linguistic and economic background.

If, on the contrary, someone who compromises is considered to be a loser, a weak, spineless person, than integration within a society, within a region is far away. Compromising is strength. From my experience here, women are rather willing to compromise than men: this is one of their strengths and should be further supported.





## **Ardjana, 43 vjeç, dy fëmijë, avokate**

Në teori, kompromisi më i mirë në kushte të caktuara është gjetja dhe arritja e një zgjidhje me përfitime për të dyja palët. Megjithatë, ajo që kam parë në realitetin e përditshëm shqiptar është që shumica e grave shqiptare jetojnë me atë çfarë mbetet nga një kompromis i keq. Shumica e grave shqiptare janë të vetmet që gjithnjë ndjekin dhe janë plotësuese të jetës, dëshirave të burrit, prindërve dhe fëmijëve të tyre.

Për aq sa ky kompromis 'i keq' nuk kufizon/shkel parimet thelbësore të moralit, do të pranoja se ai është boshti i jetës sonë shqiptare në rrethanat përkatëse dhe gratë shqiptare duhet të përgëzohen për këtë. Sigurisht, boshti do të ishte edhe më i qëndrueshëm, nëse, një grua që bën kompromis, do të kishte në krah të saj një partner që merr pjesë në një kompromis të mirë. Për këtë arsye, do të ftoja burrat shqiptarë që jetojnë me këto gra të mrekullueshme shqiptare që të punojnë për të përmirësuar boshtin e jetës, ta bëjnë kombin shqiptar të madh dhe bashkëjetesën të lumtur.

*(bazuar ne dy thenie te njohura mbi kompromisin)*

## **Ardjana, aged 43, two children, lawyer**

In theory, the best compromise in a given situation is to find and achieve a win-win solution for both involved parties. However, I have seen that in the day-to-day Albanian reality most of the women cope with what is left from a bad compromise: most of the Albanian women usually tend to follow and support the life and desires of their husbands, parents and children.

Unless such 'bad' compromise restricts/violates the fundamental moral principles, I would admit that it is the axis around which the Albanian reality revolves and that Albanian women should be recognized the efforts that regard. It is obvious that this axis would be much stronger if a compromising woman had a partner who would be part of that good compromise. Therefore, I would invite the Albanian men who live with these wonderful women to work together towards a better life, a greater Albanian nation and happy co-existence.

*(based on two famous quotes about compromise)*



### **Drita, 57 vjeç, dy fëmijë, Drejtuese e Qendrës për Zhvillimin e Grave Rurale**

Është bukur të njihesh me kompromise të realizuara nga të dy prindërit në dobi të familjes. Vitet e para të tranzicionit ishin të vështira për të gjitha familjet shqiptare, por, veçanërisht, për ato familje të cilat kishin fëmijë në moshën e adoleshencës. Ndryshimi i sistemit politiko-ekonomik nxori mjaft prindër të papunë, të cilët, për të siguruar të ardhura për familjet e tyre dhe për të mundësuar vazhdimin e arsimimit të fëmijëve, u detyruan që të bënin punë të tjera jashtë profesioneve që ata kishin. Kjo nuk ishte një situatë e lehtë dhe kërkonte kompromis midis prindërve, për hir të një të ardhmeje më të mirë për fëmijët dhe familjen e tyre. Anëtarët e familjes sime e kanë kaluar këtë vështirësi dhe sot janë të kënaqur që e kanë bërë këtë kompromis. Po kështu, përvoja disavjeçare me shoqatën gjatë zbatimit të projekteve të ndryshme në zonat rurale më ka dhënë mundësinë që të njoh nga afër raste të shumta dhe të mbushura me kompromise të natyrave të ndryshme, të cilat bëhen për mbarëvajtjen e familjes. Mendoj se boshti i familjes është kompromisi dhe se, aty ku ka kompromis, problemet gjejnë gjithnjë zgjidhje.

### **Drita, aged 57, two children, Head of the Centre for Development of Rural Women**

It is nice to get to know about compromises made by parents for the sake of their families. The early years of transition were hard on all the Albanian families, especially those with teenage children. The change of the political and economic system resulted in unemployment for many parents, who had to take up jobs outside of their profession, in order to provide for their families. This was no easy situation at all and it required parents to compromise for the sake of a better future for their children and family. The members of my family have also been faced with these hardships and they are happy for the compromise we made at that time. In addition, during my experience with the organization in the implementation of various projects in rural areas, I have had the opportunity to get to know closely many cases where various compromises have been made for the sake and benefit of the family. I believe that compromise is the foundation of the family and whenever there is will to compromise, there is a solution to every problem.



### **Manjola, 65 vjeç, pensioniste, e martuar**

Askujt nuk i pëlqen të bëjë kompromis, por secili e bën atë çdo ditë. Ne bëjmë kompromis në shtëpitë tona dhe, kur nuk kemi mundësi tjetër, bëjmë kompromis, pavarësisht se kush po shikon. Në disa raste, nuk ka asgjë zgjidhje tjetër përveç kompromisit. Unë kam punuar shumë gjithë jetën time, në mënyrë që të kisha pavarësi kur të dilja në pension dhe mos të varesha nga familja ime. Megjithatë, kur dola në pension, të ardhurat e mia ishin thjesht të pamjaftueshme. Ky kompromis është i detyruar për mua ashtu siç ishte, është dhe do të jetë i detyruar për të gjithë ata njerëz, shtetet e të cilëve kanë sistem problematik pensioni.

### **Manjola, aged 65, Retired, married**

Nobody likes to compromise, yet everybody does it every day. We compromise in the privacy of our homes and when we have no other option, we compromise no matter who is watching. At times, there is nothing we can do but compromise. I have worked all of my life really hard so that I could stand on my own feet and not depend on my family. Then I retired and my income is simply not enough. This compromise was forced on me just as it was, is and will be forced on all those people whose states have troubled pension system.



## Era, 23 vjeçe, e pamartuar, e punësuar

Kompromisi, për mua, është përfitim dhe humbje pasurore ndërmjet dy apo më shumë personave fizikë dhe/ apo juridikë, duke marrë në konsideratë më të mirën e çdo personi.

Në thelb të kompromisit është paraja, pasi çdo konflikt ka si objekt kryesor të ardhurat. Personalisht, bëj kompromise gjithmonë kur në mes është paraja, sepse, përndryshe, ka dy mundësi:

Të fitoj gjithçka, që do të ishte e mira absolute, por e pasigurt ose

Të humbas gjithçka, që do ishte një situatë tepër e pafavorshme për mua.

Zgjidhja më e mirë do të ishte një rrugë e mesme, në të cilën jam pjesërisht fituese dhe pjesërisht humbëse, si unë, po ashtu edhe personi/personat përballë meje në raste specifike. Kompromisi është ndërmjetësimi më i mirë për të ruajtur dhe fituar para.

*Kur nisa të bëj kompromis për paratë?*

Asnjëherë nuk kam reshtur.

Gjithmonë kam bërë kompromis për to.

Isha fëmijë: të afërmit më dërgonin në dyqan për të blerë diçka për ta dhe më jepnin lekë shtesë për veten time, përndryshe nuk shkoja.

Studimet e mia: Familja ime i paguante dhe unë iu falja atyre kënaqësi dhe krenari.

Çdo ditë: Shkoj çdo ditë në dyqan dhe blej me anë të parave, përdor shërbimin e transportit publik në këmbim të parave, marr produkte dhe shërbime nëpërmjet parave.

Në punë: Punoj në bazë të një kontrate, e cila, ndërmjet të tjerave, ka dhe shërbimin në para.

Në periudhën e pensionit: Do marr të ardhura si pension. Çdo gjë në jetë është e ndërtuar në bazë të parasë. Madje edhe pas vdekjes shteti iu jep familjarëve disa para.

Më e rëndësishmja: *Për çfarë i dua paratë?* PËR TË QENË E PAVARUR.

## Era, aged 23, single, employed

In my opinion, compromise is about two or more legal and/or natural entities gaining or losing assets, considering the best of each party.

Money stands at the core of any attempt to compromise, as every conflict revolves around the money. Personally, I always compromise when it comes to money, otherwise I would be faced with two options:

Win everything, which would be absolutely the best for me, but uncertain as such, or

Lose everything, which would be extremely to my disadvantage.

The best solution, instead, would be to meet half way and have a win-win situation for both the other party and myself. Compromise is the best way to keep and make money.

*When did I start to compromise for the money?*

I have never ceased doing it.

I have always compromised over money.

In my childhood: My relatives used to send me to buy things for them and had to give me additional money to keep for myself, otherwise I would not go.

During my studies: My family paid for my studies and I, instead, gave them back a sense of satisfaction and pride.

Every day: Money allows me to shop, to use the public transport, to purchase various products and services.

At work: I have a working contract which ensures me money among other rewards.

Retirement period: I will be entitled to pension incomes later in life. Everything in life revolves around money. Even after death, the state gives money to the family.

Most important: *Why do I need money?* TO BE INDEPENDENT





### **Jonida, 30 vjeç, e martuar, 1 fëmijë, Menaxhere e Burimeve Njerëzore**


Të punosh dhe të rrisësh një fëmijë duke qenë e martuar me një kapiten anije.

Duhet shumë vullnet dhe vendosmëri për të mbajtur së bashku të gjitha copëzat e së tërës (fëmija, bashkëshorti, puna), veçanërisht, kur largësia është pjesë përbërëse e së përditshmes. Shpeshherë, është e vështirë dhe shpesh bëhet akoma edhe më e vështirë, por, nëse ju dhe pala tjetër i përkushtoheni një qëllimi të përbashkët, i cili është burimi i kompromisit dhe keni objektiva të njëjta, atëherë gjërat mund të funksionojnë.

### **Jonida, aged 30, married, 1 child, HR Manager**

Working and raising a child while married to a ship captain.

It takes a lot of will and determination to keep all the bits and pieces of the picture together (child, husband, work), especially when the distance is an integral part of your daily life. Sometimes it gets hard, sometimes even harder, but if both parties are committed to the same purpose that is a result of the compromise and if they, subsequently, share common goals, then, it can all work out.



## Jonida, 21 vjeç, studente, beqare

Që në fëmijëri mbaj mend që më pyesnin çfarë doja të bëhesha kur të rritesha. Prindërit dhe të afërmit e mi kishin shumë ëndrra për mua, një panoramë të qartë për atë që unë do të bëhesha. Rritur me një frymë të tillë, ëndrrat e tyre u bënë qëllimet e mia. E dija shumë mirë që doja të bëhesha një ekonomiste e zonja. Për të arritur këtë qëllim, sfida që më lindi ishte të përfundoja universitetin me rezultate të larta, për të bërë krenarë prindërit dhe veten time. E thënë kaq shkurt, në dy rreshta, duket diçka e thjeshtë, kur në të vërtetë është shumë më ndryshe. Të arrije rezultate të larta, do të thoshte të lexoje libra të tërë, të studioje shumë, të shpenzojë orë të stërzgjatura duke punuar, duke hequr dorë nga sa e sa aktivitete që organizonin bashkëmoshatarët e mi. Nuk më harrohet ajo ditë kur kalova gjithë kohën e mbyllur në dhomë duke studiuar për një provim. Në orën 10.00 të darkës, e lodhur nga leximi, ndez celularin dhe një varg mesazhesh me vijnë në telefon. E çuditur filloj t'i lexoj një nga një. Ishin të gjitha mesazhe urimi. Në atë moment u kujtova që kisha pasur ditëlindjen... Shumë qeshin sa herë e degjojnë këtë histori; me siguri do ta bëni edhe ju që po lexoni tani. E vështirë ta besosh si mund të harrosh ditëlindjen tënde, as unë nuk do ta kisha besuar, po të mos e kisha provuar vetë... Tani, në prag të përfundimit të studimeve të mia, kthej kokën pas dhe kuptoj që ka qënë një rrugë e vështirë, po sot jam e lumtur që ëndrrat e dikurshme po bëhen realitet. Bëra kompromis me rininë time, për një të ardhme më të mirë dhe për një shans që ëndrrat e mia të bëheshin realitet.

## Jonida, aged 21, student, single

I recall people in my childhood asking me what I wanted to become as a grown up. My parents and relatives had their dreams of what I should be, a clear vision of what I would be. Growing with such aspirations, their dreams turned into my goals. I was determined I wanted to become a good economist. I knew that to attain this goal, I had to graduate with the highest score, in order to make myself and my parents proud. As easy as it may sound in a couple of sentences, it was quite hard to achieve such goal in practice. Graduation with the highest of scores would mean reading a lot of books, studying hard, spending long hours working and giving up most of the events and gatherings organized by my peers. I cannot forget one day when I spent the whole time closed in my room studying for an exam. Around 10:00 pm, when I was so tired from reading, I turned on my mobile phone and there were numerous incoming messages. Surprised, I started to read them one by one and realized they were birthday wishes. At that, I realized it had been my birthday. Many people laugh at hearing such story, and I am sure you are doing it too. It is difficult to believe that one can forget their own birthday. I would have not believed it myself, had it not happened to me. Now that graduation is drawing near, I take look back and realize how hard of a journey this has been, but I am happy that, finally, my dreams are within my grasp. I made a compromise with my youth for the sake of a better future and a chance of making my dreams come true.



## **Maria, 30 vjeç, e martuar, mësuese**

Kompromisi kur punon jashtë vendit.

Shpesh, fytyrat e njohura të mungojnë. Shpesh, janë gjërat e thjeshta, si vendet e preferuara. Bukuria e kompromisit gjendet në fytyrat e reja miqësore që të rrethojnë dhe në vendet që zbuloni bashkë.

“Për çdo gjë që ke humbur, ke fituar diçka tjetër dhe për çdo gjë që fiton, humb një tjetër”

*Ralph Waldo Emerson (Poet, lektor dhe eseist amerikan, 1803-1882)*

## **Maria, aged 30, married, teacher**

Compromising when working abroad

Sometimes familiar faces are missed. Sometimes, just simple things like a favorite place. The beauty of compromising lies in new friendly faces that surround you and new places you discover together.

“For everything you have missed, you have gained something else, and for everything you gain, you lose something else.”

*Ralph Waldo Emerson quotes (American Poet, Lecturer and Essayist, 1803-1882)*



## Adela , Ekonomiste, 28 vjec

Kompromisi është si teoria e lojës në ekonomi. Në teorinë e lojës mund të jesh në pozitën ku fitojnë të gjithë, në atë ku dikush humb e një tjetër fiton apo në një situatë ku humbasin të gjithë. Nëse bën kompromis, je në situatën ku fitojnë të gjithë. Jo gjithmonë merr maksimumin e asaj që kërkon, por të paktën merr diçka.

Çdo ditë që shkoj në punë me makinë më duhet të bëj kompromis me veten dhe të tjerët. Qëllimi im është i thjeshtë, të shkoj në punë në orar dhe shëndoshë e mirë. Për vite të tëra nervozohesha ndërsa udhëtoja me makinë nëpër Tiranë, për shkak të trafikut, rrëmujës, mungesës së rregullave, të semaforit. Policia më ndalonte mua, në vend të makinave të bukura e luksoze që shkelnin rregullat. Shumica e ditëve të mia fillonin me nervozizëm dhe me të bërtitura ndaj shoferëve e tjerë kur isha në makinë dhe, ndonjëherë, të bërtiturat vazhdonin kur shkoja në punë. Mëngjeset ishin një kaos i vërtetë. Kjo vazhdoi, derisa bëra një kompromis me veten: makina është e rëndësishme, por jeta ime është edhe më shumë. Nuk jam shofere profesioniste. Unë e përdor makinën për të shkuar në punë dhe kjo nuk duhet të më ndikojë. Kështu, mësova si ta shijoj. Gjëja e parë është të harroj të gjitha rregullat e përparësisë që mëson në kursin e patentës, se nuk funksionon ashtu. Sa më e madhe dhe e shtrenjtë makina, aq më përparësi ka ajo. Kur i jap makinës, shoh me kujdes në të gjitha drejtimet; shpejtoj kur mundem dhe ndaloj në kryqëzim edhe kur jam me jeshile. Respektoj këmbësorët, shpesh të buzëqeshin, dhe kjo ndonjëherë më ngre humorin. Komunikoj me shoferët e tjerët kur shohim njëri tjetrin. Kur është kaos, mundohem të rrëshkas ngadalë në trafik. Kur bllokohem në trafik, lexoj ndonjë artikull, ose dëgjoj muzikë, ose mendoj ose akoma më mirë shoh vitrinat e dyqaneve. Prej disa kohësh kam filluar ta shijoj makinën në Tiranë. Kam filluar të komunikoj me njerëzit ndryshe.

## Adela, Economist, aged 28

Compromising is like the game theory in economy. In the game theory you can be in the win- win situation, win- lose, lose –win or lose-lose situation. If you compromise we are in the win - win situation. You don't always get the maximum you wanted but at least you get something.

Every day I drive to work I do compromises with myself and the others. My goal is simple, to go to work on time and safe. For years I would just get mad when driving in Tirana looking at the traffic, the mess, with no rules or traffic light. Police would stop me and not the nice fancy cars that violated the rules. Most of my days would start with me being mad and shouting when driving and then sometimes shouting when going to work. My mornings were a mess. It continued until I made a compromise with myself: driving is important but my life is even more. I am not a professional driver. I drive to go to work, and this should not influence me. So I learned how to enjoy it. First thing is forget the priority rules you learn at the driving lessons class, as it does not work like that. The bigger and the fancier the car the more they have the priority. When I drive I look very carefully around; I speed when possible and stop at an intersection even with a green light. I respect pedestrian, who often give you a smile, and that cheers me up. I do communicate with other drivers with gestures, I look at them and they look at me. When the traffic is in chaos, I try to move on. If I am stuck in traffic, I read something or listen to music or spend time thinking, or even better, I look at the windows of the shops. Since sometime, I am loving to drive in Tirana. I have started to communicate with people in a different way.





### **Adelina, 41 vjeç, dy fëmijë, Zyra e Gjendjes Civile Kashar**

Gjatë përvojës sime të punës në Zyrën e Gjendjes Civile, kam hasur raste kur gratë kanë qenë të detyruara të lindnin çdo vit, derisa të lindnin një djalë (një nga rastet është një nënë 24 vjeçare me 6 vajza, e cila kishte lindur çdo vit). Nga raste të tilla, kam arritur në përfundimin që gratë shqiptare janë gati të sakrifikojnë edhe shëndetin dhe jetën e tyre për një dëshirë të burrit dhe familjes së burrit për një djalë; ky është kompromis ekstrem.

### **Adelina, aged 41, two children, Civil Registry Office Kashar**

During my work at the Civil Registry Office I have seen cases of women forced to have children every year, until a male offspring is born (one of the cases is that of a 24-year old mother of 6 daughters, who had given birth every year). From such cases I have concluded that Albanian women are ready to sacrifice their own health and even their lives just to satisfy the wishes of husbands and their families for a son; this is an extreme compromise.



## **S.D, 33 vjeç, e martuar, juriste**

Të ndërmarrësh një akt kompromisi, sado të vogël apo të konsiderueshëm, siç mund të jetë të zgjedhësh filmin e preferuar të partnerit tënd, në vend që të shohësh atë që të pëlqen ty, apo nëse je ti ajo që merr përsipër të shkojë në një vend të huaj, e vetme, duke u larguar nga familja dhe gjithcka tjetër që njeh, vetëm për hir të lidhjes tënde, është një ndërmarrje e rrezikshme, e cila i mbart të dyja anët e medaljes. Megjithatë kjo bëhet duke shpresuar se do të jetë ana e ndritur e medaljes e cila do ta thotë fjalën e fundit.

Thuhet se është më mirë të përkulesh sesa të thyesh, e cila është shumë e vërtetë, pasi kompromis nuk do të thotë domosdoshmërisht të dorëzohesh, por do të thotë të përpiqesh për të arritur zgjidhjen më të mirë të mundshme për të dyja palët. Megjithatë, kjo do të qëndronte vetëm në rastin kur të dyja palët do të ishin të përfshira në aktin e kompromisit.

Kompromisi ka të bëjë me tolerancën dhe respektin për ndjenjat dhe idetë e të tjerëve, kërkon një përkushtim të vërtetë dhe aftësinë për të depërtuar dhe për të arritur në zbulimin e dëshirave e vërteta të miqve apo partnerit. Një zgjidhje vetëm e njëanshme dhe e imponuar e problemeve, nuk mund të funksionojë asnjëherë.

## **S.D, aged 33, married, lawyer**

To perform an act of compromise, however small or big, whether it is picking your partner's favorite movie over yours to watch, or if it is you who is moving to a foreign country on your own, leaving your family and all that you know for the sake of your relationship, is bitter sweet. But, we do it in the hope that the sweet part shall prevail.

They say it is better to bend than to break, which is quite true, as compromising does not necessarily means giving in, but trying to find the best possible solution for both parties. This, however, can only be true if both parties are involved in compromise.

Compromise involves tolerance and respect for the feelings and opinions of others. It takes true commitment and the ability to discover and penetrate into the wishes of a friend or partner. A unilateral and imposed solution to problems would never work.



### **Liza, kuzhinierë, e martuar, 2 fëmijë, 54 vjeç**

Gjatë gjithë jetës sime kam bërë kompromise. Vazhdoj t'i bëj, përndryshe, nuk do të kisha qënë e aftë të përshtatesha me kultura dhe mendësi që janë ndryshe nga të miat, si ato të bashkëshortit tim. Të dish çfarë, si dhe kur të bësh kompromis është një çelës i rëndësishëm në jetë. Shpesh ai të lëndon shumë, por nuk mund të kesh arritje pa të. Isha e detyruar të martohesha me bashkëshortin tim. Ne asnjëherë nuk u përshtatem, asnjëherë nuk kishim të njëjtat dëshira; jemi qaq të ndryshëm. Bëja kompromise me veten time dhe qetësoja shpirtin për mirëqenien e familjes, sepse e doja atë. Kisha menduar shpesh të ndahesha nga ai, por nuk e bëra asnjëherë. Edhe pse punoj vetë, varem nga bashkëshorti im, sepse nuk kam pavarësi ekonomike. Edhe nëse do të kisha, fëmijët e mi nuk do ma falnin asnjëherë, nëse do ndahesha nga babai i tyre. Bëra kompromis me ëndrrat, dëshirat dhe personalitetin tim për lumturinë e fëmijëve të mi dhe për hir të familjes sime. Dje shkova të vizitohem te mjeku. M'u desh të plotësoja disa formularë. Më pyetën për emrin e tim eti. I pyeta nëse mund të jepja emrin e nënës sime, në vend të babait, por nuk ishte e lejueshme. Rashë dakord dhe i dhashë emrin e babait, edhe pse im atë ka ndërruar jetë prej vitesh, edhe pse mendoj dhe ndjej ndryshe. Nesër, fëmijët e mi do t'i pyesin për emrin e babait të tyre, siç më pyetën edhe mua. Ata nuk do kenë mundësinë të përmendin emrin tim, sepse nuk ka rëndësi dëshira e tyre si simbol i sakrificës që nëna bën për fëmijët e saj.

### **Liza, cook , married, 2 children, aged 54**

I have compromised during my entire life. I still do, otherwise, I would have not been able to adjust to a culture and mentality that is different from mine, like that of my husband. Knowing what, how and when to compromise is a very important thing in life. Sometimes it hurts very much, but you cannot achieve much without it. I was obliged to marry my husband. We never adjusted to one another and never had the same interests; we are so different. I tried to compromise with myself and find peace within for the sake of the family, and out of love. I have often thought to get the divorce, but never really did it. Although I work, I depend on my husband, because I do not have financial independence. Even if I were financially independent, my children would never forgive me if I divorced their father. I compromised my wishes, my dreams and my personality for the happiness of my children and the sake of my family. Yesterday I went to see a doctor. I had to fill in some form. I was asked to give my father's name. I asked if I could give the name of my mother instead, but it was not allowed. I agreed to it and I filled out my father's name, although he is dead since many years now and I think and feel differently. Tomorrow, my children will be asked of their father's name, just like I was. And they will not be able to mention mine, no matter how much they want to do it as a symbol of the sacrifices a mother does for her children.



### **Luljeta, 55 vjeç, e vetëpunësuar, një fëmijë**

Kompromisi vlerësohet si ide moderne. Në familje ka komunikim, ka mirëkuptim dhe kompromis. Duke komunikuar dhe vepruar në këtë mënyrë, familja krijon, ruan e përmirëson rregullat e përgjithshme, sipas të cilave jetojmë. Për shembull, bëjmë kompromis duke lejuar dhe falur sjellje e veprime të njëri-tjetrit që nuk çenojnë familjen, të cilën e vlerësojmë të shenjtë.

### **Luljeta, 55 aged, self employed, one child**

Compromise is considered to be a modern idea. In a family there is communication, good understanding and compromise. It is by communicating and acting in this way that family establishes, preserves and improves the general rules according to which we live. For example, we compromise when allowing and forgiving each other's behaviors and actions insofar as they do not harm the family, which hold sacred.



Westside  
SMARTS



## **Mira, e papunë, 55 vjeçe, beqare**

Shpesh, kompromisi nënkupton sakrificë. Isha regjistruar në një shkollë profesionale për t'u bërë stomatologe dhe, kur erdhi momenti për të shkuar në shkollë të lartë, nuk munda, sepse vëllai dhe motra ime, që ishin më të mëdhenj se unë, kishin nisur Universitetin. Në atë kohë nuk lejohej që, nga e njëjta familje, të shkonin më shumë sesa dy fëmijë në Universitet. M'u desh të bëja kompromis me të ardhmen dhe të bëhesha ndihmësmjete. Ndihesha e lumtur për vëllain dhe motrën, të cilëve iu ishte dhënë mundësia për të arritur më shumë. Kur erdhi koha që të martohesha, im atë u sëmur dhe unë vendosa të kujdesesha për të. Përsëri, vendosa të shtyja një pjesë të jetës për mirëqënien e familjarëve të mi. Ndërsa koha kalonte, unë prisja “princin” tim, por nga ana tjetër isha tepër e zënë për ta gjetur atë, sepse kujdesesha për familjen time. Më vonë, kuptova që nëna ime ishte tepër e moshuar dhe vendosa t'ia dedikoj jetën familjes që kisha dhe doja. Rashë dakord të hiqja dorë nga mundësia për të patur familjen time, ndaj shkova të jetoja me famijlet e motrës dhe vëllait tim. Gjithësesi, nuk bëra kompromis mbi dashurinë, në njëfarë mënyre. I dua nipërit dhe mbesat si të ishin fëmijët e mi dhe mënyra sesi kujdesemi për njëri tjetrin është e mbushur me dashuri dhe përkujdesje.

## **Mira, Unemployed , aged 55, single**

Often, compromise means sacrifice. I was enrolled into a professional school to become a dentist and when the time came for me to go the University I could not, because my older brother and sister had already done so. At that time, only two children from the same family were allowed to attend the university. I had to compromise my future and became a medical assistant. Nevertheless, I was truly happy for my siblings who were given the opportunity to achieve more. When it was the time for me to marry, my father got sick and I decided to take care of him. Again, I decided put off a part of my life for the well-being of my family members. Time was flying and I was waiting for my “prince” to come, but on the other hand I was too busy to look for him while tending to my family. Then I realized that my mother was too old and I decided to dedicate my life to the family I had and loved. I compromised the chance to have my own family and moved in to live with my brother and sister and their families. However, I did not entirely compromised on love, somehow. I love my nieces and nephews as if they were my own children and the way how we take care of each other is filled with love and care.



HAIR COLOR DISPLAY BOARD

MOGANO | FANTASIA | VIGINO | NOCARD

**Mogano**

- 4.5
- 1.0
- 2.0
- 3.0
- 4.0

**Rossi**

- 2.4
- 7.0
- 8.2
- 9.2
- 10.0

**Superschiarenti**

- 11.0
- 11.7

**Correttori**

- 4.04
- 7.04
- 8.04
- 9.04

**Natural**

- 1.0
- 2.0
- 3.0
- 4.0
- 5.0

**Natural Cold**

- 4.01
- 5.01
- 6.01
- 7.01
- 8.01

**Natural Flame**

- 4.04
- 7.04
- 8.04
- 9.04

**Fo**

### **Ana, 33 vjeçe, e martuar, një fëmijë**

Kompromisi për mua është të jetosh mirë, kudo që të jesh, si dhe të jetosh në harmoni. Unë i dua njerëzit dhe jam shumë tip social. Për këtë, duhet të krijoj mjedisin tim kudo që jam.

Jam martuar me tim shoq prej gjashtë vitesh. Kompromisi im i parë ishte të kisha një lidhje në largësi. Vitet e para të njohjes me tim shoq, ai jetonte në Itali dhe unë në Shqipëri. Takoheshim dy herë në vit. Pas katër vjetësh lidhje në distancë, u martuam. Pasi mbarova studimet, vajta në Itali tek im shoq dhe hoqa dorë nga mundësia për të gjeturit një punë në Shqipëri. Vitet e para në Itali ishin të vështira, pa shoqëri dhe pa një punë, por krijova familjen time.

Me fillim e krizës, filluan dhe problemet. Sapo unë gjeta një punë të mirë në Itali, im shoq mbeti pa punë dhe rroga ime nuk mjaftonte për të paguar kopshtin e djalit dhe për të mbajtur familjen, ndaj vendosëm të ktheheshim në Shqipëri. Tani jetojmë me familjen time dhe une kam hapur një parukeri në pjesën e pasme të shtëpisë. Kompromisi im është i thjeshtë, nuk kam një shtëpi timen dhe jetojmë të tre në një dhomë, por bëj një punë që e dua dhe ndiej kënaqësi.

### **Ana, aged 33, married, one child**

To me, compromise means to live well and in harmony where ever you are. I love people and I am a very social person, and for that purpose I have to create my own environment everywhere I am.

I have been married to my husband for six years now. My first compromise was having a distance relationship. When I first met my husband, he was living in Italy and I was living in Albania. We would meet only twice a year. After four years of a distance relationship, we got married. After I finished my studies I left for Italy and gave up any job opportunities in Albania to be with him and to build my own family. The first years in Italy were difficult; I had no job, no friends, but I had started my family.

Problems started with the beginning of financial crises. As soon as I got a good job, my husband lost his. Our income was not enough to pay our son's kindergarten and support our living there at the same time, so we decided to come back to Albania. Currently, we are living with my family. I have opened my own hair salon on the back side of the house. My compromise is simple, even if we don't have our house anymore and we live the three of us in one room, I have my own salon and I do a job which I enjoy.



### **Alda, 42 vjeç, sanitare, e martuar, dy fëmijë**

Intelekti, finesa dhe edukata janë çelësi kryesor i suksesit, që femra të triumfojë në të gjitha shoqëritë e prekura nga interesi. Të jesh inteligjente do të thotë të vendosësh për të ardhmen tënde, ndërkohë që diktatorët të privojnë prej saj. Të kesh finesë do të thotë të kërkosh rritje page, edhe kur punëdhënësi ndodhet në krizë ekonomike. Të jesh e edukuar do të thotë të përshëndesësh në gjuhën e punëdhënësit të huaj kur punon, edhe pse nuk ke pasur mundësinë të mësosh atë gjuhë në të shkuarën. E nëse një femër i ka këto cilësi, ndihet mirë shpirtërisht dhe arrin të bëjë kompromise të vështira, pasi do t'i duhet të përmirësojë punën e saj pa prekur interesat e të dyja palëve dhe pa dëmtuar njëri tjetrin, përpos zgjedhjeve që i jepen në jetë, në të mirë të familjes.

### **Alda, aged 42, cleaning lady, married, two children**

Intellect, charm, and behavior are the main key in order for a woman to succeed in all the societies guided by the interest. Being smart would mean to decide on your own future, even if “dictators” deprive you of it. Charm means to ask for a raise of salary, even when the employer is faced with an economic crisis. Being polite is to know how to greet by using the foreign language of your employer, although one has not been able to learn any foreign languages in the past. If endowed with such qualities, a woman feels good and manage to make difficult compromises in order to improve her performance, without affecting any of the parties involved, for the good of their families.



**Anida, 30 vjeçe, e martuar, dy fëmijë, kamariere**

Pa kompromis është e vështirë të ketë përparim dhe kompromisi duhet të mbështetet edhe nga personat që kemi pranë. Mendoj se është e rëndësishme që kompromiset e njëpasnjëshme të diktojnë përparim dhe të mos ndikojnë/ndryshojnë atë që donim në fillim të rrugëtimit tonë.

**Anida, aged 30, married, two children, waitress**

Progress without compromise would be difficult to achieve, thus, compromise should be supported by the people around us. I believe it is important that continuous compromises lead us toward progress, while they should affect/alter our goal at the beginning of our journey.





## Lejla, 60 vjeç, pensioniste

*Kompromisi është:* 1. *Përputhje mendimesh* 2. *Aprovim*

Në familje ekziston gjithmonë kompromisi me bashkëshortin dhe me fëmijët.

Kur diçka nuk na pëlqen, e themi dhe e diskutojmë me burrin dhe fëmijët.

Në punë: Idealistët nuk pranojnë kompromis, dalin edhe kundër rrymës dhe nuk e pranojnë.

Në nivel profesional: Nuk pranoj kompromis, por tani mendoj se nuk i bihet murit me kokë.

Kompromisi në vendin tonë ka shumë nivele. Pse nuk ka kompromis tek ne?

Nuk ka, sepse ka shumë ndërhyrje dhe fyerje. Të ne kompromisi nuk është mbi nivelin mesatar. Dhuna që ekziston tek ne tregon se kompromisi është në nivele të ulëta.

Në shoqëri: Ekziston kompromisi negativ, sepse njerëzit kanë nevojë për punë, duan të përfitojnë. Më shumë është mirëkuptim sesa kompromis. Ti bën në kompromis, sepse të detyrojnë rrethanat.

Në nivelet e korrupsionit:

Kompromisi shikohet si bazë e korrupsionit. Në punë, nuk punon shumica, por pakica. Nga ana tjetër, nuk e lënë punën, se u duhet të mbijetojnë. Korrupsioni është institucionalizuar në sajë të kompromisit negativ.

## Lejla, aged 60, retired

*Compromise is:* 1. *Convergence of opinions* 2. *Approval*

In the family there is always compromise with my husband and my children. When there is something wrong we communicate and discuss together, with my husband and children.

At work: Idealistic people do not accept compromise, even when it is against all and everything.

On the professional level: I do not compromise, but now I think that one cannot hit the wall every time. There are different levels of compromise in our country. How come there is no compromise here? The reason is that you are faced with so much interference and insults. Compromise is below the average in this country and the existing violence is an indication of that.

In the society: We are faced with as negative compromise, because people need work and want to take advantage of you. More than compromise, I would call it a bargain. One tends to compromise as they are forced by the circumstances.

Corruption level:

Compromise is seen as the basis for corruption. At work you only have a minority of people who do their job, as compared to a majority who doesn't. On the other hand, people do not quit as they need to survive. It is because of this negative compromise that corruption has been institutionalized.



## Lindita, 35 vjeç, e martuar, 2 fëmijë, sekretare

*Në përplasje me veten dhe të tjerë*

Symbyllur dhe heshtur gërmoj me gishtat e këmbëve rërën e lagur. Një dallgë shkon e vjen, më lëpin këmbët e luan me mua si të ishte qenush i vogël.

Qëndroj e pathyer në verbërinë time, nuk dua të shoh, për asnjë arsye nuk dua të shoh. I mbaj të mbyllur sytë, fort, fort dhe i komandoj ata, më mirë se çdo shqisë tjetër që kam. Kështu siç jam më mjafton aroma e kripur e detit, klithma e pulëbardhës, zhurma e dallgëve, për të kuptuar se ç'më rrethon. E kam dashur gjithmonë detin dhe, natyrisht, e dua edhe tani. Është si dashuria e parë, nuk harrohet. Në çdo moment, kur më vjen në mendje të bëj ca ditë pushim, mendja dallgëzohet së pari për bregun e detit, për dashurinë time të parë me jetën.

Është e shenjtë drita e syve, aq e shtrenjtë sa nuk mund ta shpenzoj pa kriter për të parë atë që më rrethon. Ndjem keq në këtë çast dhe nuk do të doja të ndaja me askënd atë që kam brenda vetes. Këtu ku rri ulur dhe meditoj jam vetëm, vetëm deti më bën shoqëri. Mund të ishte një shok i mirë me të cilin të ndaja atë që më bren, atë që më bën të qëndroj vetëm dhe symbyllur. Por jo, edhe me detin nuk mundem, po mbetem më mirë vetëm. Në një botë ku të mbytet hipokrizia, duhet të dish mirë të përballësh me gjithçka, por, ja që, ndonjëherë, harrojmë. Harrojmë që jo të gjithë na duan e na respektojnë për atë që jemi apo për atë çka kemi arritur, edhe atëherë kur gjërat i kemi arritur pa penguar të tjerët apo pa prishur ekuilibrat e vendosur. Për çdo veprim të bërë kanë një gjykim dhe dyshojnë deri dhe te lulet që vendos në tavolinën e punës. Aty ku kaloj pjesën më të madhe të ditës, shoh dhe dëgjoj shumë. Në të shumtën e rasteve, dua të reagoj, të thërras, të kundërshtoj, por s'mundem. Ndihem e pafuqishme, aq e dobët, sa dhe zëri brenda meje struket dhe fshihet ku të mundë.

Më vjen në mendje Migjeni. Dua të marr nga revolta e tij, por s'kam guxim. Më duhet një krah i fuqishëm ku të mbështetem a një mburojë ku shigjetat e helmura të armiqve të mos më godasin. Veprime të dyshimta, fjalë të liga, shifra marramendëse, intriga të thurura në avlëmente akademikësh, të gjitha kalojnë përpara meje. I shoh, i prek, i ndjej dhe në të gjitha rastet vuaj. Edhe një këngë të dëgjuar nga këto gojë të liga nuk mundem ta dëgjoj, më vjen si vaji i vajtojave të kobshme. Më duhet të hesht, nuk kam zgjidhje tjetër, për aq kohë sa nuk mund të ndryshoj asgjë nga të gjitha sa shoh, më mbetet të rri symbyllur dhe, rrjedhimisht, të hesht.

Në bregun e detit, ulur rri. Symbyllur dhe heshtur gërmoj me gishtat e këmbëve rërën e lagur. Një dallgë shkon e vjen, më lëpin këmbët e luan me mua si të ishte qenush i vogël. Qëndroj e pathyer në verbërinë time, nuk dua të shoh, për asnjë arsye nuk dua të shoh. Ja, sytë i mbaj të mbyllur, i komandoj aq mirë sa s'kam ç'të them, por veshëve si t'ua bëj? Të dëgjoj, të hesht, të mos shoh, të vazhdoj të jetoj në këtë mënyrë, s'është aspak e këndshme, e përvuajtshme, reale. Migjen, më duhet guximi yt, ku ta gjej? Deri kur kështu më? Ah!

## Lindita, aged 35, married, 2 children, secretary

*In the face of myself and the others*

I am standing amidst the shore in silence, with my eyes closed, as my toes dig in the wet sand. There's a wave that comes and goes and licks my feet like a playful puppy.

I cling to my blindness, for I don't want to see, for no reason at all. My eyes are shut and I can command them better than any of my other senses.

The smell of the sea, the sound of the seagulls and waves are just enough for me to have a feeling of the surroundings. I have always loved the sea, and I still do. It's like the first love, never forgotten. Whenever I think of taking a few days off, my mind starts to make waves and go to the sea, my first love of life. I hold the light of my eyes so dear, that I cannot waste it in vain to see what's around me. I feel so bad right now that I would not want to share what I have inside with anyone. I am alone where I am standing, with the sea being the only one to keep me company. It could be the friend with whom I would share what is consuming me and while staying with my eyes closed. But I cannot even do this, so it is better that I am left alone, with myself. We live in a world ruled by hypocrisy rules and one should be prepared to face everything, but we tend to forget it. We forget that people do not love us for who we are and for what we do, although you have not stepped into anyone's toes. Every action is prone to judgment and even flowers placed on your desk are a reason to cause doubts. I see and hear so many things at my work where I spend most of my day. There are so many times I want to react, to shout out loud, to object, but I feel I can't. I feel powerless, weak. Even the voice inside me hides deep within, wherever it can.

It reminds me of Migjen. I want to make some of his rage mine, but I lack in courage.

I need a strong shoulder to lean on, to feel safe, to shelter me from the venom of enemies. I come across suspect deeds, evil words, huge amounts of money, intrigues woven out of an academics' cloth. I can hear all these, feel them, touch them and suffer all the same. I have to keep silent, for as long as I have no other choice. I cannot change anything of what I see, thus, it is better to keep my eyes close, my mouth shut.

I am standing amidst the shore in silence, with my eyes closed, as my toes dig in the wet sand. There's a wave that comes and goes and licks my feet like a playful puppy.

I cling to my blindness, for I don't want to see, for no reason at all. My eyes are shut and I can command them as best as I can, but what about my ears? To listen, to be silent, to refrain from seeing, to keep living like this again and again is not good; it is sheer suffering. Migjen, I need your courage! Where do I find it? AH!



## Miranda, planifikuese urbanistike, 40 vjeç, e martuar

*Zona e bregdetit Kaos - në syrin e një gruaje - Kompromis për të rregulluar kaosin*

Fillova një plan-studim peizazhi - punë e bukur për studimin e vijës bregdetare shqiptare nga ishulli i Franc Jozefit, deri në kepin e Stillos, në kufi me Greqinë, 450 km bregdet. Në mënyrë që të ruanim vijën natyrale ku deti bashkohet me tokën, me kompromis, vendosëm një limit 300m larg nga bregu, i cili është në rregull nga aspekt ligjor. Fillimisht, studimi eci mire. Menjëherë, sa nisën interesat dhe u abuzua me ligjin, kufiri u ul deri në 100 m në zonën jugore dhe abuzimet vazhdojnë. Ndihem e pamundur të mbroj dhe të jap argumente për situatën aktuale, si edhe pse gjyshërit tanë nuk ndërjuan kaq afër detit. Bëra kompromis për të shpëtuar disa zona, por edhe këtu plani nuk funksionoi dhe kaosi zotëron bregdetin. Unë ndihem keq, e mundur, që ne nuk mund të mësojmë nga gabimet dhe eksperiencia e të tjerëve, por po bëjmë përsëri të njëjtat gabime. Kështu, puna ime u reduktua në Tiranë, në një objekt të vetëm dhe bëra kompromis me veten që unë nuk mund të vuaj më.

Kompromiset pozitive munguan dhe asnjëherë nuk u diskutua hapur me argumente për arsyet. Unë nuk kisha mundësi, u tërhoqa dhe bëra kompromis për hir të punës që më pëlqente, për hir të pagës si burim jetese, por kaosi nuk u rregullua.

Nëse argumentojmë, kompromisi për rastin në fjalë është një koncept për të gjetur marrëveshje nëpërmjet komunikimit, nëpërmjet një pranimi të ndërsjellë të termave dhe, shpesh, përfshin variacione nga një qëllim origjinal apo dëshirë minimale për mjedisin ku jetojmë. Çfarë na pengon? Mendësia dhe përtacia, “realiteti ekstrem”, politika dhe vendimmarrja, interesat e çastit, fitimi, mungesa e aspektit ligjor, aspekti kulturor, etj.

## Miranda, Urban Planer, aged 40, married

*The chaos of the coast in the eyes of a woman - the compromise to fix the chaos.*

I started a landscape study – a very nice job to study the Albanian coastline from the island of Franc Jozef up to the Cape of Stillo in the borders with Greece, which makes for 450 km of coast. In order to protect the natural lineage and the harmony between the sea and the land, we achieved a compromise to set the construction limit at a distance of 300 m from the shore, which was fully in line with the law. The study proceeded smoothly in the beginning. However, as soon as there were interests which became part of the whole, the law was entirely disregarded and the limit shrunk into 100 m. I feel it is impossible for me to defend or argue over this situation or even explain why our grandparents did not build at such distance. I made a compromise to save some of the Albanian areas, but I failed in doing so and the chaos is ruling. I feel miserable and defeated for not learning from the mistakes of others, but, instead, tend to repeat them. I started to work in Tirana and I made a compromise with myself that I am not going to suffer anymore.

Positive compromises were missing and we never discussed the “whys” and “hows”. I had no possibility to do so and I made a compromise in the name of a job that I loved and for the sake of salary, but it did not tackle the chaos.

If I have to define compromise for the case in question, I would say that it is an agreement achieved through communication, a mutual acceptance of terms and, often, it would involve many variations to the original purpose and the readiness to have a better environment. What are the obstacles then? It is the mentality, laziness, the “extreme reality”, politics and decision-making, short term interests, profits, gaps in the legislative aspect and culture; it is all of them together.



### **B.S, 38 vjeç, e punësuar, e martuar**

Iluzioni është e vetmja shpresë pa kompromis.

Kanë të drejtë ata që thonë se, në punën tonë të përditshme, duhet të kemi kujdes se me çfarë kompromisesh kemi të bëjmë. Të lind pyetja, a janë ato në funksion të punës, në funksion të plotësimit të standardeve të përcaktuara për t'u ndjekur e zbatuar e, si rrjedhim, në funksion të së ardhmes më të mirë apo janë abuzime dhe manipulime të individëve të pasinqertë?

Besoj se kompromisi aktual është i dobishëm dhe ai duhet të jetë gjithmonë vetëm në funksion të moscënimit të ligjit, sigurisë dhe drejtësisë në marrjen e vendimeve.

Megjithatë, fatkeqësisht, ndodh shpesh që kompromiset shpesh herë kompromiset janë të tilla që nuk kënaqin asnjë palë.

### **B.S, aged 38, employed, married**

Illusion is the only hope without compromise.

They are right when saying that we should be careful of the compromises we are faced with in our daily work. The question is now being posed as to whether such compromises contribute to the scope of our work, to meeting the standards set to be followed and enforced, and, subsequently, to go towards a better future, or whether they are mere manipulations by from dishonest individuals? I believe that compromise is useful and it should always be in favor of the law, order and justice when decisions are made. But, unfortunately, it often occurs that compromises are such as they make no one happy.



Tiranë  
Prishtinë  
Ljubjanë  
Sarajevë  
Beograd  
Sofie  
Bukuresht  
Zagreb  
Podgoricë  
Athinë  
Stamboll  
Shkup

IDEATOR  
Institut i Kulturës Popullore - Tiranë, Albania

ORGANIZATORE:  
Akademitë e Shkencave  
Institutet Shkencore të Ballkanit

MINISTRITË E KULTURËS  
TE VENDËVE BALLKANIKE  
Përfaqësitë Diplomatike



## Afërdita, 65 vjeçe, Etnologe

Në punën time si drejtuese e një institucioni, kam kuptur se sukcesi i drejtimit varet shumë edhe nga aftësia për të bërë kompromis, e të bërit kompromis për problemet që kanë të bëjnë me të mirën e përbashkët.

Sigurisht, bëhet fjalë për kompromise që nuk drejtojnë vlerat morale të personit dhe institucionit. Jam e mendimit se të bërit kompromis nuk lidhet me faktin nëse je burrë apo grua. Mendoj se është aftësi personale e drejtuesit. Mendoj se, së pari, njeriu duhet të bëjë kompromis me veten, që do të thotë të heqësh dorë nga disa dukuri të temperamentit tënd, të pranosh, të kërkosh të falur e të falësh të tjerët.

Kompromis duhet bërë në momente kur vihet në rrezik harmonia midis grupeve të njerëzve, për të ruajtur mbarëvajtjen dhe për t'i dhënë zgjidhje një problemi.

Mendoj që një njeri tolerant ka rezerva të mjaftueshme për të realizuar atë që këtu, po e quajmë kompromis.

Si drejtoreshë e një institucioni që përbëhet nga një numër relativisht i madh punonjësish dhe që ka shumë probleme për të zgjidhur, mendoj se çelësi i suksesit tim ka qenë pikërisht fakti se kam bërë kompromise në çastin e duhur.

## Afërdita, aged 65, Ethnologist

Working as the director of an institution, I have realized that success depends also on the ability to make compromise for the sake of the common good. Let us be clear, however, this is not about those compromises that go against the human and institutional moral values. I am of the opinion that compromise has nothing to do with being a man or a woman and that it is a manager's personal skill. It is my opinion that, first, one has to make compromises with themselves, which means that they have to give up certain traits of behavior, to accept, to ask for forgiveness and to forgive others.

Compromises need to be made in those moments where the harmony between people is jeopardized, so that issues can be addressed.

I am of the opinion that a tolerant person has enough resources to make compromises.

As the director of an institution that includes a considerable number of employees and has many issues that need to be tackled, I would attribute the success of my leadership to the fact that I knew when to compromise.



## **Eldira, 50 vjeç, projektuese urbanistike**

Nisur nga jeta e përditshme dhe pozicioni i punës, je e detyruar të bësh gjëra për të cilat nuk je e bindur apo e gatshme t'i bësh.

Ndonjëherë, më duhet të firmos dokumente duke mos qenë e bindur se është gjëja më e mire për t'u bërë, por detyrohem nga rrethanat, presionet, pozicioni i punës. Kompromis, në shumë raste, është të mos veprosh dhe ky është kompromis me veten, për të qetësuar ndërgjegjen. Kur duhet marrë një vendim, i cili nuk përmbush kriteret e kërkuara në ligj, shpesh, më duhet të abstenoj, për të mos dalë kundër shumicës që e miraton vendimin, si dhe për të mos dalë kundër eprorëve të mi. Edhe pse e di që, nëpërmjet abstenimit nuk shpreh mendimin tim, më duhet ta bëj, por, të paktën, nuk votoj pro një shkeljeje. Kompromis është të pranosh të keqen më të vogël, por jo domosdoshmërisht të marrësh vendimin më të mirë.

## **Edlira 50 aged, Urban planner**

Sometimes, in our daily lives or at work, we are forced to do things which we are not convinced of or willing to do.

It happens at times that I have to sign certain documents being forced by circumstances, pressure by others and by my job position, although I am not convinced that it is the right thing to do.

Omission is, quite often, a compromise which you make with yourself, in order keep your conscience clear.

In cases of decisions which fail to meet legal criteria, I often opt to abstain, to avoid going against the approving majority and my supervisors. Although I am aware that by abstaining, I refrain from expressing my own opinion, I find it the right thing to do, because, at least, I will not vote in favour of a violation. Compromise means choosing the least of evil, but it does not, however, make for the best decision.



## **Ledia, Stiliste, e martuar, 28 vjeç**

Në profesionin tim është më e vështirë të bashkëpunosh me femrat, sesa me meshkujt. Këta të fundit i kanë idetë më të qarta për atë çfarë duan. Edhe nëse nuk ndodh kështu, është më e thjeshtë të bësh kompromis për një veshje që do t'iu plotësonte nevojat. Me femrat është më e vështirë, pasi gjithmonë pretendojnë të kenë më të mirën, më të bukurën, por rrallë herë kanë një ide të qartë për atë çka duan. Kjo e bën më interesant bashkëpunimin me to, por, sigurisht, jo më të thjeshtë. Gjithësesi, në fund arrihet një kompromis për të kënaqur të dyja palët.

## **Ledia, fashion designer, married, aged 28**

In my profession it is much more difficult to work with women than with man. Men have clearer ideas on what they really want. Even if this is not the case, it is easier to compromise with a man on clothes that would meet their needs. On the contrary, things turn out more difficult with women, because they always pretend to have the best, although it rarely happens that they have a clear idea of what they looking for. This is what makes it interesting to work with them, although not easier for that matter. However, finally we come to a compromise that satisfies both.



### **Linda, pastruese 45 vjeç, arsim 8-vjeçar, nga Peqin**

Po bëj kompromis me veten për të bërë pastruar shtëpi të ndryshme, nisur nga gjendja shumë e ngushtë ekonomike. Më duhet të përballem me paragjykimin e bashkëfshatarëve dhe të klienteve të mi. Jam e detyruar të thyej dhe mentalitetin e burrit, i cili, në disa raste, nuk është dakort me punën që unë bëj.

Ka familje ku punoj, që më trajtojnë shumë mirë dhe nuk me ofendojnë, por ka dhe familje të tjera që, për një gjë të vogël, të ofendojnë dhe të fyejnë, por, nisur nga nevoja, nuk ndihem.

### **Linda, cleaning lady, aged 45, primary education, Peqin**

I am making a compromise with myself to work as a cleaning lady in various houses, because of my poor economic conditions. In doing so, I have to face the prejudice of my village community and my customers. At times, I have to deal with the mentality of my own husband, who is not comfortable with the job I am doing.

Amongst the families I work at, there are those who treat me very well and do not insult me, as well as others who can be harsh on you even for the smallest of things, but I do not react, considering that I need the job.





## **Elena, 30 vjeç, e martuar, një fëmijë**

Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit, Karta Themeluese e NATO-s, parashikon se sulmi i armatosur kundër një aleati do të konsiderohet si sulm i armatosur kundër të gjithë anëtarëve.

Parë nga një këndvështrim i ngushtë, kompromisi për t'u bërë vend anëtar i NATO-s është të konsiderosh armik atë të cilin nuk e kishe konsideruar më parë si të tillë.

Vendi ynë, për të garantuar sigurinë e zonës së Atlantiku të Veriut ku tashmë bën pjesë, vendosi të kontribuojë me dërgimin e trupave tona në misionet luftarake në Afganistan dhe Irak.

Shpeshherë, nga historia që përsëritet, kemi mësuar se njerëzit quajnë Kompromis Publik edhe krimet, duke i emërtuar jo si të tilla, por si “mjete” për të arritur realizimin e objektivave të caktuara.

Këtë përcaktim mund ta quaj si një kompromis i dhimbshëm, duke marrë si shembull dhe ngjarjen e fundit ku vendi ynë u përball me humbjen e njërit prej ushtarëve, bijve të tij në misionin ushtarak në Afganistan, Kapiten Feti Vogli. Kapiten Feti Vogli na kujton se kufijtë e atdheut tonë, jo në kuptim fizik por të vlerave që përfaqëson atdheu për çdo qytetar, vlerat e lirisë, demokracisë dhe sigurisë, janë sot shumë më të mëdhenj dhe shumë më të shtrirë.

Sakrifica e Kapiten Feti Voglit dëshmon se jemi gati që, me sakrificën e bijve tanë, të mbrojmë këto vlera të përbashkëta që qendrojnë në themel të asaj që na bashkoi me aleancën e Atlantikut të Veriut dhe asaj që na bashkon në përpjekje dhe sfidat tona për t'i siguruar qytetarëve shqiptarë jo vetëm sot apo nesër, por për brezat që vijnë, standardet, sigurinë, lirinë, demokracinë dhe të mirat që gëzojnë aleatët tanë. Kompromis ky i domosdoshëm për mbijetesën e këtij kombi të vogël.

## **Elena, aged 30, married, one child**

Article 5 of Washington Treaty, NATO Charter, provides that an armed attack against one or more members, shall be considered an an attack against all the members.

In a narrow perspective, the compromise in becoming NATO member state is to consider as an enemy even that which you did not previously.

In order to guarantee the security of North Atlantic Area, which our country is a member to, our country decided to contribute by sending our soldiers in peacekeeping missions in Afghanistan and Iraq.

History has often taught us that people may consider crimes as a “Compromise in the Public Interest” and, rather than describing them as such, portray them as means to achieve their goals.

I would call this definition a painful compromise, recalling the last event where our country was faced with the loss of one of its soldiers who was part of the peacekeeping mission in Afghanistan, Captain Feti Vogli.

Captain Feti Vogli reminds us that the borders of our country are much greater and extended today, not in physical terms, but in terms of those values that a country represents for each of its citizens, including the values of freedom, democracy and security.

The sacrifice of Captain Feti Vogli proves that we are ready to sacrifice our children to defend these common values, which are at the core of what made us join the Northern Atlantic Alliance and what brings us together in our efforts and challenges to provide the standards, freedom, democracy and all the benefits of our allies to the Albanian citizens, not only for today or tomorrow, but for all the generations to come. This is an indispensable compromise to the survival of this small nation.



## Shpresa, 50 vjeçe, sindikaliste

Kompromisi është zgjidhje e një problemi. Puna ime ka të bëjë me arritjen e kompromiseve, jo për veten time, por për të tjerët. Kur negociojmë për kontratat kolektive të punës, duhet të plotësojmë dëshirat e shumicës. Më duhet të negocioj fuqishëm dhe të mos kem kthim mbrapa. Ne bisedojmë për rritje pagash, kushte më të mira pune, paga në varësi të specializimit dhe viteve të punës, etj.

Protesta është shkak i mohimit të të drejtave. Shumica e negociatave që bëj përfundojnë me një kompromis. Kam organizuar më shumë se dhjetë protesta si sindikaliste. Një prej protestave ka zgjatur më shumë se dy muaj. Shoqëria punëdhënëse i trajtonte shumë keq punonjësit dhe në mënyrë jonjerëzore. Si pasojë e protestave, shoqëria u largua dhe iu pagoi punonjësve për dy vjet 60% të pagës. Ky ishte një rrezik për punonjësit, por shumica bëri një marrëveshje që ishte për kushte më të mira pune. Sot, shoqëria administrohet nga një tjetër firmë, e cila i trajton punonjësit më mirë.

Kompromisi im është të marr vendime të vështira, edhe kur palët nuk bien dakort. Në shumicën e vendimeve përfshihen shumë punonjës dhe shumë familje. Shpeshherë, mban shumë kosto mbi shpinë, së bashku me përfaqësuesit e tjerë të punonjësve. Vendimet janë jo gjithmonë më të mirat, por ato që japin alternativën më të mirë për momentin.

## Shpresa, aged 50, unionist

Compromise is the solution to a problem. My work consists in achieving compromises not for myself, but for others. When we negotiate the collective work agreements, we try to satisfy the needs of the majority. I have to be determined in striking a bargain and never look back. We negotiate over increased salaries, better working conditions, skill-based pay, working experience, etc.

A strike is the result of negated rights. Most of the negotiations I conducted have resulted in compromise. I have organized more than 10 strikes as an unionist. One of them lasted for more than two months. The employing company was treating its employees in a very inhuman way. As a result of the strike, the company left the country and paid to the employees 60% of their salary for two years. This was a risk at the expense of the employees, but majority decided make a bargain for better working conditions. Today, the company has a different management, which is treating the employees much better.

My compromise is to take difficult decisions even where the parties do not agree. Most of the decisions involve a lot of people and families. Often, we bear the cost, together with the other workers' representatives. We do not always take the best decisions, but those which ensure the best alternative in a given time.



### **Lili, kopshtare, e martuar, një djalë, 39 vjeç**

Jam e lodhur nga jeta. Është një jetë e mbushur me dhimbje dhe sakrificë. Kam dy motra, njëra prej të cilave jeton në një qytet tjetër. Nëna ime është fizikisht e paaftë, pasi humbi shikimin para dhjetë vjetësh dhe, që prej asaj kohe, jam kujdesur për të. Unë e pastroj, i shërbej dhe ndjej dhimbjen e saj. Kompromisi im është i thjeshtë. Kam pranuar që të rri me të gjatë gjithë kohës dhe të lë time motër të jetoj pjesërisht jetën e saj. Motra ime rri me të, në mënyrë që unë të mund të punoj. Ndihem sikur kam dy punë. U bënë 20 vjet që nuk shkoj me pushime. Gjatë paradites, punoj si kopshtare dhe, pas kësaj, i shërbej nënës sime dhe kujdesem për familjen. Kur vjen mëngjesi dhe shkoj në punë, hyj në një botë tjetër, në botën time. Më pëlqen të punoj në kopsht dhe të shoh lulet që çelin, të rrethohem nga njerëz të mirë e të bisedoj me ta. Kjo është ajo që ndjej, për kompromisin për të cilin paguaj.

### **Lili, gardener, married, one son, aged 39**

I am tired of my life as it has been filled with pain and sacrifice. I have two sisters one of whom lives in another town. My mother is physically disabled, after she lost her sight ten years ago and I have been taking care of her since then. I clean her, I tend to her needs and feel her pain. Mine is a simple compromise. I have chosen to stay with her all the time and allow my sister to live part of her life. My sister stays with our mother, for the time I need to go to work. I feel as if I have two jobs. I have not been on holidays for more than 20 years now. I work as a gardener in the morning and, after that, I nurse my mother and take care of my family. When the morning comes and I go to work I enter an entirely different world, my world. I love to work in the garden and watch flowers bloom, to be surrounded by nice people and talk to them. That is how I feel about compromise, which I am still paying for.



## **Klanda, 39 vjeç, kontabiliste**

Jeta nisi e vështirë me martesën e parë dhe vazhdoi me vuajtje në martesën e dytë. U ndava nga bashkëshorti im i parë për arsye tradhtie, duke marrë me vete time bijë. Pas kësaj, u martova me shkuesi me një burrë tjetër, i cili më keqtrajtoi mua dhe time bijë. Dhuna që ai ushtronte ishte sa psikologjike, po aq edhe fizike. Jetova e martuar me të rreth 4 vjet, por u ndava dhe nga bashkëshorti i dytë. Megjithatë, opinioni të vret. Përveç dhunës, im shoq ishte pijanec dhe i papunë. Tashmë jetoj me qira me fëmijët e mi (vajzën nga martesa e parë dhe djalin nga martesa e dytë). Unë bëj tri punë, që dorën të mos ja zgjas kujt, ndërsa ime bijë kujdeset për vëllain e vet. Asnjë nga fëmijët nuk ka dashurinë dhe mbështetjen e baballarëve të tyre, as atë financiare. Jam e gatshme të pranoj të bëj çdo lloj pune, mjafton që të marr para. Kompromisi im është të mbaj fjalën që iu kam dhënë fëmijëve të mi, që të mos martohem për herë të tretë, sepse “kur s’ të ngroh dielli i mëngjesit, mos prit të të ngrohë ai i darkës”, si dhe të punoj vetëm për të rritur ata fëmijë, në mënyrë që të mos iu mungojë asgjë. Kështu, do iu zbus disi fëmijërinë e pakëndshme që kanë kaluar.

## **Klanda, aged 39, accountant**

I started life the hard way with my first marriage and the suffering continued in the second one. I divorced my first husband because of infidelity and took my daughter with me. After that, I had an arranged marriage to another man, who used to mistreat me and my daughter. He used to exercise both physical and psychological violence. I stayed married to him for about four years and then I divorced him too. But, the opinion of people was devastating. My ex-husband was violent, an alcoholic and unemployed. Currently, I live in a rented apartment with my children (my daughter from the first marriage and my son from the second). I work three jobs, in order to make my living, while my daughter takes care of her little brother. None of my children has the love of their fathers and neither any financial contribution from them. I am ready to take every type of job, in order to earn money. I have made a compromise with myself, promising my children not to marry a third time, as “when the morning sun does not warm you, neither can that of the evening”. I work only for my children, so that they have everything. Only in this way will I help them get over the troubled childhood they have been through.





## Vjollca, 45 vjeç, nënë e tre fëmijëve

Kam qenë e martuar për 27 vjet me një burrë shumë xheloz dhe fanatik, i cili nuk më linte të bisedoja me asnjë njeri. Më ka dhunuar fizikisht për shumë vite me radhë, që prej fillimit të martesës sonë. Punoja dhe nuk doja të lëvizja nga puna kur vinte orari që duhej të shkoja në shtëpi, pasi nuk e duroja dot atë njeri. Qëndroja me të për hir të prindërve të mi, të cilët më thonin “ashtu e kanë burrat, po he...”. Problemet arritën kulmin sa i kemi drejtuar gjykatës katër here. Herën e fundit gjykata vendosi që ai të largohej nga shtëpia. Tashmë ai është larguar nga shtëpia dhe është zhdukur; nuk e di më se ku bëhet. Tashmë jetoj me fëmijët e mi 21, 18 dhe, më i vogli, 4 vjeç. Ai nuk kujtohet më as për ta. Unë punoj në një dyqan si shitëse gazetash për 800 lekë në ditë. Punoj dhe jetoj me lekë borxh. Pas xhelozisë së paduruar të tim shoqi, tani më duhet të duroj edhe fanatizmin e tim biri. Tani, djali i vogël më pyet për të atin që s’e njeh dhe unë i tregoj vetëm fotografitë e tij, ndërsa vajza, për arsye fanatizmi të të atit, është vetëm me arsim tetëvjeçar. Ai nuk e lejoi të vazhdonte shkollën e mesme. Ka shkatërruar shumë jetë me pijen, xhelozinë dhe dhunën e tij. Dhuna arrinte deri atje sa mund të vriteshim, por ishin fëmijët që na ndanin. Mbjaj mend që e rrihte edhe vajzën tonë dhe kjo më dhembte më shumë se çdo goditje. Kompromisi im në jetë ka qenë çdo ditë, kompromis me xhelozinë e tij, dhunën e tij, keqtrajtimet e tij. Pranoja një vuajtje për hir të diçkaje. Tani pranoj të rris fëmijët e mi e vetme duke u torturuar për të mirën e tyre.

## Vjollca, aged 45, mother of three children

I used to be married to a jealous and fanatic man for 27 years. He did not allow me to talk to anyone and abused me physically since the beginning of our marriage. I used to work at that time and when the time came for me to go home at the end of the day; I did not want to leave, as I couldn't bear with that person. I used to stay with him for the sake of my parents, who always told me, “this is what men are like ...”. The situation exacerbated to that point that we went to the court four times. Finally, the court ruled that he had to leave the house. Now that he has left, he has disappeared and I know nothing about him. Actually, I live with my children, 21, 18 and the youngest who is 4. He does not care about them anymore. I work in a shop and sell newspapers for 800 Lek a day. Nevertheless, I live on borrowed money. As if my husband's jealousy was not enough, I have to deal with my son's fanaticism. My youngest one asks me about his father and I only show him pictures, while my daughter has only completed eight years of education, because her father was so fanatic as to prevent her from attending secondary education. He ruined many lives with his alcohol consumption, jealousy and violence. Things became so violent that we could have killed each other, but it was our children who managed to contain us. I remember that he used to beat our daughter and that hurt me more than anything. I compromised with my life every single day; I dealt with his jealousy, his violence, his ill-treatment. I took all the suffering for the sake of something. Now, I raise my children alone, bearing all hardships for their sake.



### **Ersida, 34 vjeç, Fier, e punësuar**

U martova 9 vjet më parë me dashuri. Tashmë jam ndarë, sepse tortura dhe dhuna që im shoq ushtronte ndaj meje më bëri të mos duroj dot më. Kam dy djem, të cilët po i rris vetë, me një rrogë që fitoj si punonjëse në supermarket. Babai i tyre nuk kontribuon as me detyrimin për ushqim, të vendosur nga gjykata. Ato nëntë vjet me të nuk mbaj mend të kem pasur një ditë të bardhë. Më rrihte deri në tre të mëngjesit, duke më lënë pa fuqi. Shpesh herë, kur vinte i dehur zgjonte edhe djalin e madh nga gjumi, i bërtiste dhe e qëllonte. Me ne jetonin edhe prindërit e tij, mirëpo ata nuk mund të bënin asgjë, ai nuk i dëgjonte. Tani jetoj me dy fëmijët tek shtëpia e prindërve, por atje jetojnë edhe im vëlla me bashkëshorten dhe kjo më ka vënë sërish përballë problemeve. Vëllai me të shoqen nuk e pëlqejnë situatën time dhe nuk i duan fëmijët e mi aty. Kompromisi im vazhdon nga shtëpia e tim shoqi, në të cilën bëja kompromis me dhunën e deri tani, që bëj kompromis me dhunën psikologjike dhe problemet që shkaktohen, për shkak se familjarët e mi nuk m'i duan fëmijët. Megjithatë, tani jam më mirë. Opinioni i njerëzve nuk më vret, jam e zonja e vetes dhe djemve të mi. Ndërkohë po merrem me procedurat e dokumentave për të pastrehët.

### **Ersida, aged 34, Fier, employed**

I got married to a man I loved 9 years ago. Now, we are divorced, because of the violence he put me through. I could no longer live with it. I am mother to two sons, who I am raising on my own with a salary from my job in a supermarket. Their father does not contribute at all and gives no child support, as ruled by the court. I don't remember even a single happy day in those nine years. He used to beat me until three in the morning, while I fainted. Often, when he came home late and he was drunk, he used to wake the elder son and hit him. His parents lived with us as well, but they were helpless; he did not listen to them. Currently, my two children and I live at my parents' house, where my brother and his spouse live, as well. This situation is another source of problems I have to face. My brother and his wife are not comfortable with my current situation and they do not want the children to live there. My compromising started at my husband's house, with his violence, and it still continues, while I have to deal with the psychological violence and problems caused by my family members, who do not want my children to stay with them. Nonetheless, I am actually better than before. I don't care about what people say. I am capable of taking care of myself and my sons. In the meantime I am filing documents as homeless.



## Fabjola, 19 vjeç, studente, Durrës

Gjithçka filloi kur isha 16 vjeç. Në fakt, të gjitha “ligësitë” kishin nisur që kur isha fëmijë dhe jetonim në Berat. Ne jemi tri motra dhe një vëlla. Babai im ka pasur gjithmonë një mëri të vjetër me kushëririn tim. Mirëpo, kushëriri im, i cili është sipërmarrës i madh, u hakmorr duke përdorur armën më të keqe, nxitjen e dhunës në familje. Ai e nxiste babanë tonë të mendonte gjërat më të këqija për ne. Babi vinte në shtëpi gjithmonë i acaruar dhe i nevrikosur. Gjente shkaqe absurde për të ndezur debatet në familje dhe, pas debateve, përfundonte duke goditur motrat dhe mamin. Normalisht që dhe unë do isha viktimë e tij, nëse nuk do të punoja deri në orën 11 të natës, që në moshën 16 vjeç. Rastet e shëmtuara të dhunës psikologjike që kam parë nga im atë kanë qenë kërcënime me thika drejtuar neve, familjes së tij... Njëherë, pasi na kishte trembur duke na kërcënuar me thikë, u ul në divan dhe motra e madhe e mori thikën, iu ul në gjunjë dhe i tha: “Meqë kjo është dëshira jote, na vrit. Më vrit mua të parën”. Edhe im atë punon sipërmarrës dhe është shumë mirë ekonomikisht. Ai na kërcënonte, na shante në mes të rrugës, na bënte të ndiheshim fajtorë, sepse, sipas tij, ishim ne që e lëndonim. Njëherë bëri sikur piu helm miu; ne vërtet u shqetësuam. Njëherë, kur na kërcënoi keq me vdekje, ne u detyruam të bënim denoncim në polici dhe të kërkonim mbrojtje nga shteti. Arritëm, përmes gjyqesh të shumta, të fitonim shtëpinë dhe policia e largoi nga shtëpia. Pavarësisht gjithçkaje që na kishte bërë, u ofrova që ta ndihmoja dhe të jetoja me të, por ai më tha: “Nëse vjen të jetosh me mua, nuk do shkosh as në shkollë, as në punë dhe do hash kur të them unë.” Ai donte të na burgoste në shtëpi, donte të ishim gjithmonë nën hijen e tij. Madje, shpesh, më çonte tek njerëzit e tij të më bënin moral. Përveç dhunës fizike dhe psikologjike, ai dhunoi dhe jetët tona. E martoi motrën me një të pasur, pa pyetur çfarë njeriu ishte. Motra atje dhunohej nga të gjithë, madje, edhe nga vjehrra e vet. Erdhi një ditë dhe motra donte të kthehej në shtëpinë tonë, por babai i tha që nuk mund të kthehesh në shtëpi me fëmijën. Motra u detyrua ta linte vajzën aty dhe të kthehej në shtëpi. Tashmë, ajo jeton me ne dhe vajzën e sheh vetëm njëherë në javë. Tani im atë është martuar dhe nuk e vret mendjen për ne, as për djalin e tij të vetëm. Madje, kam frikë se, herë pas here, do shfaqet aty për të na lënduar. Kompromisi im në jetë ka qenë të heq dorë nga “bëmat e ëmbla” të rinisë dhe të punoj fort për familjen time, për personalitetin tim dhe për t’i treguar tim ati dhe njerëzve të tij, që, ndonëse femër, edhe unë mund të jem sipërmarrëse. Që në moshën 17 vjeç, munda të hap me motrat e mia një dyqan operator të telefonisë celulare, i cili tashmë është zgjeruar edhe në profile të tjera, si sigurimet shëndetësore dhe si agjenci turistike. Kam pranuar, brenda vetes, që ai është im atë. Pavarësisht çfarë ka, bërë unë nuk mund ta urrej, por as nuk mund ta fal, sepse na shkatërroi gjumin e rinisë dhe, për më tepër, më dha shembullin më të keq të një mashkulli. Çdo vajzë kërkon që “princi i saj” të jetë si babai i saj. Unë nuk kërkoj princ, sepse kam frikë se do t’i ngajë tim ati.

## Fabjola, aged 19, student, Durres

Everything started when I was 16. Well, actually, all “evil” had a start when I was a child and we lived in Berat. It is four of us, three sisters and one brother. My father used to have an old conflict with my cousin. But, on the other hand, my cousin who is a big entrepreneur, backfired by instigating violence within our family. He always pushed our father to think the worst of us. My father used to come home irritated and nervous. He always found reasons to fuel discussions and ended up hitting my sisters and my mother. Obviously, I would have been a victim as well, if I had not been working up to 11.00 pm since when I was 16. Amongst the ugliest violence episodes I have witnessed from my father included threatening us, his family, at knifepoint. Once, after scaring and threatening with a knife, he set on the sofa and one of my sisters took the knife, kneeled down and told him: “If this is what you want, kill us. Kill me first.” My father is an entrepreneur, as well and his economic situation is quite good. He used to threaten and insult us when outside and made us feel guilty, because we were the ones who, according to him, caused all the hurt. One time, he made us believe he had taken poison and we got worried indeed. Further, when his life threats became quite serious, we had to report him to the police and ask for the protection of state. After numerous trials we managed to keep the house, and the police forced him out of there. However, despite of everything my father had done, I offered to help and live with him, but what he told me was: “If you come to live with me, you will not go either to school or to work and you will eat when I tell you to.” He wanted to keep us prisoners at home, always under his shadow. Often, he took me to his relatives so that they lectured me about morality. He did not only put us through physical and psychological violence, but he tore our lives apart. He forced my sister to marry a rich man, without caring what kind of a person he was. Everybody there violated my sister, even her mother-in-law. There was a time when my sister wanted to come back home but my father told her she could not return with her child. My sister saw herself to leave her daughter at her husband’s and come back. Currently, she can meet the child only once a week. My father has remarried and he does not care about us or his only son. At times, I fear he will appear at our door to hurt us again. My compromise in life has been to give up the “sweet things” of youth and work hard for my family, for my personality and to show my father and his people that I can be an entrepreneur, although I am a woman. I managed to open a mobile telephone operator shop with my sisters since I was 17, and now it has extended its activity to include health insurance and tour operator services. I have accepted with myself that he is my father. I cannot hate him for what he did, but neither can forgive. He destroyed our youth and, moreover, gave me the worst example of a man. Every girl wants for her “prince” to be like her father. I, instead, look for no prince at all, because what I fear is for him to be like my father.



## Dituri, Librazhd, 49 vjeçe, shtëpiake

Gjithçka filloi kur isha 29 vjeç. U martova me shkuesi me një burrë të ve, i cili kishte tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë, përkatësisht të moshës dhjetë, shtatë dhe pesë vjeç. Kur u martova, nuk e dija që bashkëshorti im nuk kishte shtëpi, por kishte një barakë të vogël të pabanueshme. Megjithatë, u martuam brenda muajit dhe fillova të jetoj me ta në atë “banesë” pa kushte. Pas martesë, im shoq iku në Itali si emigrant dhe, një muaj pas largimit të tij, kuptova që kisha mbetur shtatzënë, për më tepër me dy binjakë. Ishte e tmerrshme për mua, sepse i kishim tashmë tre fëmijë. E mora në telefon për t’i dhënë lajmin, të cilin e priti jo me dëshirë të madhe. Kur lindën fëmijët (djalë dhe vajzë), ai erdhi në Shqipëri dhe aty tmerri mori përmasa më të mëdha. Ai filloi të më gjuante pa arsye, për shkak se ishim të varfër. Për më tepër, nuk sillte asnjë lek nga Italia. Madje, më gjuante edhe në sytë të fëmijëve të tij (fëmijët më kishin treguar se ai kishte dhunuar edhe nënën e tyre të ndjerë). Pasi fëmijët binjakë mbushën 5 muajsh, vura re që vajza kishte probleme me veshkën dhe, me ndihmën e familjes së prindërve të mi, e çoj për vizitë në Tiranë. Mirëpo mjekët na thanë se ishte i nevojshëm operacioni. E marr në telefon tim shoq, i cili vazhdonte të ndodhej në Itali, pasi kjo ishte jeta që ne bënim (ai në Itali, vinte herë pas here për të më dhunuar mua fizikisht dhe psikologjikisht, ndërsa unë rrisja pesë fëmijët e tij, midis tyre, edhe dy të mitë, në një kotec). I thashë që vajza duhej të operohej, ndaj ai duhej të vinte në Shqipëri, por nuk e vuri ujin në zjarr e, madje, më bërtiti pse kisha shkuar në Tiranë të vizitoja vajzën. Megjithatë, erdhi dhe vajza u operua, por duhej të qëndronte në spital për një periudhë prej 3 muajsh. Jam torturuar në spital e vetme. Ai, njëherë që erdhi, shkoi në dhomën e një infermiereje dhe flirtonte me të. Gjatë gjithë jetës sime me të, jam rrahur prej tij brutalisht, jam tradhtuar sy për sy. Ai prishte paratë që fitonte në emigracion e kështu vitet shkuan. Fatmirësisht, një ditë erdhi dhe u shfaq në jetën tonë, pasi përftuam nga një projekt për të pastrehët dhe u bëmë me banesë të re në një pallat. Nuk ma priste mendja, që, pikërisht, ata fëmijë që kisha rritur, do vazhdonin makthin e nisur nga i ati i tyre. Fëmijët që gjeta tani janë përkatësisht 30, 27 dhe 25 vjeç. I ati i ka rregulluar në Itali të tre, mirëpo njëri prej tyre është fejuar dhe e reja vinte në shtëpinë tonë dhe ngjallte debate. Ata nuk më duan më, për më tepër, duan të më përzënë nga shtëpia, jo vetëm mua, por edhe motrën dhe vëllain (nga i ati). Problemet dhe zënkat mes meje dhe tim shoqi (i cili, tashmë, është ligjërisht ish-bashkëshorti im) morën dhenë dhe morën përmasa të mëdha, aq sa kemi pasur raste dhe kemi shkuar në polici. Ndaj, kemi zgjidhur martesën, por jetojmë të dy nën një çati ende. Fëmijët e tij (sidomos e reja) vazhdojnë të këmbëngulin të më përzënë nga shtëpia, duke më bërë një mijë e një të zeza mua dhe fëmijëve të mi. Absurditeti më i madh ishte kur më denoncuan mua për dhunë ndaj ish-bashkëshortit tim dhe arritën të merrnin nga gjykata një urdhër ndalimi për të qëndruar larg tij për një vit, ndërkohë që ishte ai, ish-bashkëshorti im, që më dhunonte fizikisht, por edhe seksualisht. Ne vazhdojmë jetojmë në një çati me fëmijët tanë binjakë, të divorcuar, por si bashkëshortë. Dhuna vazhdon, stresi po ashtu, por e pranoj këtë situatë për dy fëmijët e mi, që ata të rriten me babanë e tyre dhe për të pasur një strehë, ku të fusim kokën të tre, pasi në të kundërt s’e di si do ishte fati ynë. Jemi pa mbrojtje.

## Dituri, Librazhd, aged 49, housewife

Everything started when I was 29 years old. I had an arranged marriage with the widower father of three, two sons and one daughter, who at that time were 10, seven and five years old. When I got married I did not know that my husband did not live in a house, but in a small barrack that was impossible to live in. Nevertheless, we got married in one month and I started my life in that “shelter” that lacked everything. After the wedding my husband emigrated to Italy, while, later that month, I realized I was pregnant with twins. It was terrible; we already had three children. I called to tell him the news, which he was not so happy to receive. Once the children were born, he came to Albania and horror started. He hit me with no apparent reason only because we were poor and our means were scarce. Moreover, he never brought money home from Italy. He used to beat me in front of his children (they had told me he used to mistreat their late mother, as well). When the twins became five months, I learned that my daughter had a kidney problem and helped by my parents I took her to the hospital in Tirana. Doctors told me she needed surgery. I called my husband who continued to live in Italy (this was our life; he lived in Italy and came back from time to time to violate me, both physically and psychologically, while I raised his five children in a barrack). I told him our daughter needed surgery and he should come back, but he could not care less and even shouted at me for having taken the child to Tirana to be examined. However, he finally came and our daughter had the surgery, but she had to stay hospitalized for three months afterwards. It was torturing to stay alone at the hospital. He only came once and, even then, went to the nurses’ room and started to flirt with one of them. I have been brutally beaten and cheated on by this man during my entire life. He spent all the money he earned working in emigration. Fortunately, a light appeared in our lives after benefiting from a project for the homeless and had our first house in a new building. I could not think, though, that the children I had raised myself would add to the nightmare their father started. Actually, the children I found are 30, 27 and 25 years old. Their father has helped them to a better life in Italy, but one of them has been engaged and his fiancée comes to our house and fuels discussions. They do not love me anymore and even worse they want me out of the house, together with their stepbrother and stepsister. Conflicts between me and my husband (now, my legally ex-husband) exacerbated so much that we even went to the police several times. They were the reason for us to put an end to our marriage, but we still live under the same roof. His children (especially, the fiancée) keep insisting that I should leave the house and they cause so many troubles to me and my children. What’s most absurd, they reported me of violating my ex-husband and managed to ensure a restraint court order for one year, at a time when it was my former husband he who abused me physically and sexually. We continue to live in the same house with our twins; divorced, but like spouses at the same time. Distress and violence are persistent but I accept this situation for the sake of my two children, so that they are raised with the presence of their dad, and also because we need a shelter, otherwise I do not know how things would be. We have no protection.





### **Klodjana, 36 vjeç, e martuar**

Kompromisi është rënie dakord me njerëz të ndryshëm, për çështje të caktuara në jetë. Kompromisi nuk është vetëm përfitime pozitive, por edhe marrja përsipër e rreziqeve dhe detyrimeve. Kompromisi më i rëndësishëm në jetën time ka qënë martesë. Pas martesës, kompromise zinxhir vinin njëri pas tjetrit. Pas marrveshjes për t'u martuar, marrveshje të tjera për lindjen e fëmijëve, për blerjen e një shtëpie, një makine, përzgjedhjet e pushimeve, marrje vendimesh dhe zgjidhje problemesh here pas here.

### **Klodjana, aged 36, married**

Compromise is an agreement, with different persons for different topics during the whole life. Compromise isn't only beneficiaries, but also engagement with duties and risk. The most important compromise in my life was my marriage/wedding. After my marriage a lot of other compromises came, one after the other. After the agreement to be married, other agreements were, having children, purchase of a house, a car, choose holidays, taking different decisions and resolving problems time by time.





